

## **Vendim nr. 103 datë 14.05.2024**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, në datën 14.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (H) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:**           **HAJRIE NURAJ**, përfaqësuar nga avokat Sokol Puto.

**OBJEKTI:**           **Rihapje e procesit gjyqësor kushtetues.**  
**Shfuqizimi i vendimit nr. 242, datë 21.12.2016 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.**  
**Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2016-2159 (228), datë 29.06.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.**  
**Kthimi i çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për vazhdimin e gjykimit.**

**BAZA LIGJORE:**   **Nenet 42, 43, 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 71/c, pikat 3, 4 dhe 6 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesja ka qenë e punësuar pranë ambasadës së shtetit të Katarit (*punëdhënësi*) me kontratën e datës 01.04.2012 në pozicionin e sekretares. Në datën 24.11.2014 punëdhënësi e ka ndërprerë marrëdhënien e punës, me motivacionin për shkelje të konfidencialitetit dhe disiplinës. Me pretendimin se kontrata e punës është zgjidhur në shkelje të procedurës ligjore dhe pa shkaqe të justifikuara, kërkuesja ka ngritur padi në gjykatë për dëmshpërblim financiar.

2. Gjatë shqyrtimit gjyqësor përfaqësuesi i punëdhënësit ka paraqitur kërkesë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar, pasi, sipas tij, bazuar në Konventën e Vjenës të vitit 1961 “Për marrëdhëniet diplomatike” (*Konventa e Vjenës*), përfaqësitë diplomatike kanë imunitet ndaj çështjeve gjyqësore. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4709, datë 13.02.2015, ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë, me arsyetimin se mosmarrëveshja i përkiste së drejtës private dhe jo asaj publike, dhe si e tillë nuk ishte e lidhur me sovranitetin e shtetit. Sipas asaj gjykate, rrëzimi i juridiksionit do të shkaktonte shkeljen e së drejtës themelore të kërkueses për t’iu drejtuar gjykatës.

3. Mbi bazën e rekursit të drejtpërdrejtë të punëdhënësit, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2015-1245 (187), datë 08.04.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se në kontratën e punësimit palët nuk kishin përcaktuar gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ndaj mbështetur në legjislacionin shqiptar dhe në Konventën e Vjenës, imuniteti i shtetit të huaj nuk mund të përjashtohet.

4. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), me pretendimin se i ishte cenuar aksesi në gjykatë. Gjykata, me vendimin nr. 18, datë 15.03.2016, ka vendosur pranimin e kërkesës, shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim pranë saj. Në arsyetimin e saj Gjykata është shprehur se Gjykata e Lartë duhet të verifikonte pretendimin e shtetit të huaj se kërkuesja kishte pasur akses në “*një sërë dokumentesh konfidenciale*” që i kishte përkthyer për ambasadën, si dhe të përcaktonte nëse detyrat specifike të kërkueses në ambasadë përfshinin ushtrimin vetëm të detyrave administrative apo kontribuonin në përmbushjen e objektivave sovranë të shtetit të përfaqësuar, për të verifikuar më pas nëse zbatohet ndonjë prej kufizimeve të imunitetit shtetëror në mosmarrëveshjet e punësimit, siç parashikohet në nenin 11 § 2 të Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për imunitetet juridiksionale të shteteve dhe pasurive të tyre” të vitit 2004.

5. Në rishqyrtim, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2016-2159 (228), datë 29.06.2016, ka vendosur sërish prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare, me arsyetimin se veprimtaria e kryer nga

kërkuesja lidhej me sovranitetin e shtetit të huaj dhe kontrata në fjalë hynte në sferën e veprimeve të lidhura drejtpërdrejt me përmbushjen e misionit ose funksionit diplomatik sipas Konventës së Vjenës. Sipas Gjykatës së Lartë, punëdhënësi nuk ka dashur të heqë dorë nga privilegjet dhe imuniteti diplomatik, ndaj juridiksioni përcaktohej bazuar në parashikimet për imunitetet.

6. Kërkuesja ka paraqitur sërish ankim kushtetues në Gjykatë, duke pretenduar se edhe vendimi i dytë i Gjykatës së Lartë i mohonte aksesin në gjykatë. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, me vendimin nr. 242, datë 21.12.2016, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se Gjykata e Lartë gjatë rigjykimit të çështjes kishte përmbushur detyrimet që rridhnin nga vendimi i parë i Gjykatës, si dhe u kishte dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të palëve, ndaj pretendimi për cenimin e aksesit në gjykatë ishte haptazi i pabazuar.

7. Në datën 13.05.2017 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), duke u ankuar për shkelje të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës, sipas nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), për shkak se gjykatat kanë refuzuar të shqyrtojnë pretendimet e saj për zgjidhjen e padrejtë të marrëdhënies së punësimit si pasojë e imunitetit shtetëror. *GJEDNJ*-ja, me vendimin e datës 10.10.2023, ka konstatuar shkelje të së drejtës së kërkueses për t'iu drejtuar gjykatës sipas nenit 6 § 1 të *KEDNJ*-së. Vendimi i *GJEDNJ*-së është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 164, datë 14.11.2023.

8. Pas dhënies së vendimit të *GJEDNJ*-së, kërkuesja, mbështetur në nenet 494 – 500 të Kodit të Procedurës Civile, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për rishikimin e vendimit për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit dhe dërgimin e saj për vazhdimin e gjykimit në shkallë të parë. Në datën 10.11.2023 çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë, e cila ka publikuar në faqen zyrtare të saj njoftimin se ajo është planifikuar të shqyrtohet në dhomën e këshillimit, në datën 05.06.2024.

9. Në datën 05.02.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për rihapjen e procesit gjyqësor kushtetues. Kërkesa, pasi është plotësuar sipas parashikimeve ligjore, është regjistruar në datën 19.02.2024. Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

## II

### Pretendimet e kërkueses

10. *Kërkuesja*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara duhet të shfuqizohen, pasi *GJEDNJ*-ja ka konstatuar shkelje të së drejtës së aksesit dhe rivendosja e kësaj të drejte përbën detyrim për Gjykatën, në respektim të nenit 46, pika 1, të *KEDNJ*-së. Sipas

saj, Gjykata duhet ta shqyrtojë çështjen në seancë plenare dhe të urdhërojë gjykatën e shkallës së parë për vazhdimin e gjykimit, me qëllim që kërkueses t'i garantohet akses i plotë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

### III

#### Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

##### A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

11. Neni 132, pika 1, i Kushtetutës, i konkretizuar në nenin 72, pika 7, të ligjit nr. 8577/2000, parashikon se vendimet e Gjykatës janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Ndërsa sipas nenit 5 të Kushtetutës, Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të. Në përputhje me këtë parim themelor, neni 71/c, pika 3, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se nëse Gjykata ka vendosur më parë për një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për rihapjen e procesit gjyqësor.

12. Gjykata, gjatë shqyrtimit të kërkesave për rihapje të procesit kushtetues, ka vlerësuar se individi, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë të paraqesë kërkesë të tillë brenda 4 muajve nga botimi në Fletoren Zyrtare i vendimit të gjykatës ndërkombëtare. Kërkesa duhet të përmbajë një përmbledhje të vendimit të gjykatës ndërkombëtare me çështjet kryesore që ka konstatuar ajo gjykatë, kërkimet konkrete dhe kërkuesi duhet të kërkojë shprehimisht rihapjen e procesit, si dhe shfuqizimin e aktit. Qëllimi i kërkesës për rihapjen e procesit është rivendosja e individit në situatën që ishte para shkeljes së konstatuar, ndaj një kërkesë e tillë nuk përbën ankim të ri kushtetues, me të cilin individi mund të paraqesë shkaqe të reja ose të ndryshme nga ato që ka paraqitur në ankimin fillestar. Vendimi për rihapjen merret nga ajo trupë – Kolegj, Mbledhja e Gjyqtarëve ose Gjykata që ka dhënë vendimin në procesin që kërkohet të rihapet (*shih vendimin nr. 67, datë 06.12.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se kërkuësja i është drejtuar dy herë Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes së saj, që lidhej me marrëdhënien e punësimit, cenonte të drejtën e aksesit në gjykatë të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 § 1 i KEDNJ-së. Në rastin e parë, Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, megjithatë kjo e fundit edhe pas rishqyrtimit, vendosi sërish nxjerrjen e çështjes së kërkueses jashtë juridiksionit gjyqësor. Në rastin e dytë, Mbledhja e Gjyqtarëve, me

vendimin nr. 242, datë 21.12.2016, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, me arsyetimin se nuk përmbushet kriteri *ratione materiae*, pasi pretendimet ishin haptazi të pabazuara. Në vijim, kërkuesja i është drejtuar një gjykatë ndërkombëtare, GJEDNJ-së, e cila, pasi ka pranuar ankesën, ka konstatuar shkelje të së drejtës për akses në gjykatë, të garantuar nga neni 6 i KEDNJ-së. Në këto rrethana, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se shqyrtimi i kërkesës për rihapjen e procesit pas vendimmarrjes së GJEDNJ-së i takon asaj, duke qenë se vendimi më i fundit i Gjykatës është disponuar prej saj.

14. Për sa i takon themelit të kërkesës për rihapjen e procesit, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se GJEDNJ-ja në vendimmarrjen e saj ka konstatuar se pika kryesore e mosmarrëveshjes ishte nëse punëdhënësi gëzonte imunitet dhe thelbi i çështjes është nëse kufizimi i kundërshtuar ndaj së drejtës së kërkueses për t'iu drejtuar gjykatës ishte proporcional. Sipas GJEDNJ-së, gjykatat vendase janë mbështetur në faktin se kërkuesja ishte e punësuar në një ambasadë të huaj dhe kishte pasur akses në materiale të papërcaktuara që supozoheshin të ishin sensitive. Ndërkohë, shprehet GJEDNJ-ja, nuk ka ndonjë indicie se kërkuesja është punësuar “për të realizuar funksione të caktuara në ushtrim të autoritetit qeveritar”, pasi kontrata e punësimit nuk përmbante asnjë përshkrim pune të detajuar dhe se ajo ishte rekrutuar për të punuar si “oficere administrative” dhe/ose “sekretare” për ambasadë, funksion që, në mungesë të ndonjë shpjegimi tjetër, nuk mund të barazohet me ushtrimin e autoritetit qeveritar të shtetit në fjalë. Po kështu, GJEDNJ-ja ka vënë në dukje se për të nuk është e qartë se çfarë elementesh e kanë çuar Gjykatën e Lartë në përfundimin se kërkuesja kishte pasur akses në informacione konfidenciale ose sensitive. Në çdo rast, një akses i caktuar ndaj informacioneve sensitive, siç mund të jetë rasti për një person në cilësinë e sekretares së një ambasadori, nuk mund të barazohet me përmbushjen e funksioneve të caktuara në ushtrimin e autoritetit qeveritar. Në vendimin e Gjykatës së Lartë, sipas GJEDNJ-së, nuk ka asnjë referencë të ndonjë përcaktim i bërë nga “kreu i shtetit, kreu i qeverisë ose ministri i Punëve të Jashtme” apo të ndonjë rrezik potencial që kërcënon interesin e sigurisë së Katarit. Pretendimi i thjeshtë se kërkuesja mund të ketë pasur akses në dokumente të caktuara ose mund të ketë pasur informacion për materiale konfidenciale gjatë detyrave të saj nuk është i mjaftueshëm që të çojë në një përfundim tjetër (*shih paragrafët 31 – 33 të vendimit të GJEDNJ-së*). Për rrjedhojë, ka vlerësuar GJEDNJ-ja, është shkelur neni 6, paragrafi 1, i KEDNJ-së dhe në kushtet kur ajo nuk ka dhënë asnjë gjykim për ligjshmërinë e shkarkimit nga detyra, i takon kërkueses të kërkojë të rihapjen proceset vendase (*shih paragrafët 36 dhe 39, po aty*).

15. Në këto rrethana, Mbledhja e Gjyqtarëve vë në dukje se ndonëse GJEDNJ-ja ka gjetur shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, në aspektin e cenimit të së drejtës së aksesit, ajo ka evidentuar se

ky cenim nuk ka ardhur si pasojë e vendimmarrjes së Mbledhjes së Gjyqtarëve, por si pasojë e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, e cila, sipas GJEDNJ-së, ka penguar realizimin e së drejtës së kërkueses për rregullimin e pasojave nga zgjidhja e padrejtë e kontratës së punës. Për pasojë, mënyra e duhur për rivënien në vend të së drejtës së shkelur të kërkueses do të ishte rihapja e çështjes nga ajo gjykatë.

16. Në këtë pikë, Mbledhja e Gjyqtarëve thekson se mbështetur në nenin 5 të Kushtetutës, vendimet e GJEDNJ-së janë të detyrueshme për t'u zbatuar, në përputhje me angazhimin që Republika e Shqipërisë, si shtet anëtar i Këshillit të Evropës ka ndërmarrë sipas nenit 46, pika 1, të KEDNJ-së, që parashikon se palët e larta kontraktuese zotohen t'u binden vendimeve përfundimtare të GJEDNJ-së në mosmarrëveshjet në të cilat janë palë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 20, datë 01.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pranuar rëndësinë për rihapjen e çështjeve, duke e konsideruar, në disa raste, si të vetmen formë të mundshme të “*restitutio in integrum*” dhe efektive për vënien në vend të së drejtës së shkelur të mbrojtur. Në këtë rast, rihapja e procedurave gjyqësore në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm mund të jetë efektive nëse vendimi i GJEDNJ-së ka dalë në konkluzionin se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut, pikërisht nga procedura jo të drejta të ndjekura prej tyre (*shih vendimin nr. 45, datë 01.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se Gjykata e Lartë duhet të mbajë në konsideratë standardet e mësipërme në shqyrtimin e kërkesës për rihapjen e gjykimit të kërkueses pranë saj, ndaj kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese nuk pranohet.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenin 71/c të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Mospranimin e kërkesës për rihapjen e procesit gjyqësor nga Gjykata Kushtetuese.